alphanova

in Kooperation mit beratungsgruppe.at

# HIPPY – Program i vizitave shtepiake per prinder me femije te moshes parashkollore

**HIPPY** – emer i cili rrjedhe nga gjuha angleze dhe eshte shkurtese per
Home Instruction for Parents of Preschool Youngsters (udhezime shtepiake per prinderit e femijeve te moshes parashkollore).

**HIPPY u eshte i perkushtuar prinderve e posacerisht nenave,** te cilat **pervec qe kane perkrahje nga kopshtet**, mund te keshillohen se si t'i pergadisin femijet e tyre per shkolle dhe si mund te kene me shume sukses ne profesionin e tyre.

**HIPPY** eshte nje program edukativ, nderkombetarisht i suksesshem dhe interkultural dhe eshte i parapare **ne veqanti per familjet e emigranteve**:

**Personat qe bejne vizitat shtepiake kane prejardhje te njejte** sikurse familjet te cilat ata i vizitojne. Te njejtit **vizitojne nenat** te cilat marrin pjese ne kete program nje here ne jave dhe ju **sjellin** materiale mesimore si dhe lojera te ndryshme**. Keta persona ushtrojne me nena** dhe i udhezojne ato per keto materiale dhe u pergjigjen pyetjeve qe mund t'i kene nenat. Lojerat, librat me fotografi dhe fletat per ushtrime te HIPPY-t jane ne gjuhen gjermane. Personi qe ben viziten mund edhe te perkthej permbajtjen e tyre. Nje vizite shtepiake zgjat me se shumeti nje ore**. Detyra e nenes** eshte qe te ben **ushtrime** me kete material mesimor **cdo dite nga 20 minuta** me femiun/ femijet e saj. Ne kete menyre meson edhe nena edhe femiu, dhe jo vetem gjermanisht. Ata mesojne se sa zbavites mund te jete mesimi se bashku.

**HIPPY –Nenat** e ketij programi kane mbi te tjera edhe mundesine qe te **takohen rregullisht ne grupe** dhe t'i shkembejne pervojat e tyre. Takimet ne grupe te HIPPY-t udheheqen nga pedagoge te shkolluar te cilet shqyrtojne temat sic jane edukimi, ushqimi dhe shendeti dhe perkujdesen qe te kete shkembim informatash.

**Nga programi HIPPY perfitojne te gjithe anetaret e familjes:**
- Femiu sepse nena e tij angazhohet rreth tij intenzivisht dhe ai me ane te lojes meson.
- Motrat/Vellezerit sepse shohin se sa zbavites mund te jete mesimi.
- Babai poashtu sepse mund te mburret me familjen e tij e posacerisht me gruan e tij.
- Si dhe nena sepse eshte e lumtur per sukseset e perbashketa, behet me e guximshme kur kontakton me njerez dhe institucione sic jane kopshti apo shkolla, mund te arrije me shume ne jete dhe respektohet me shume nga familja.

**HIPPY eshte Ndihme per Vetendihme**, behet ne menyre vullnetare dhe u jep perkrahje familjeve qe kane femije te moshes 3 vjeqare deri sa te fillojne te shkojne ne shkolle. Ne rast nevoje programi **HIPPY** mund t'u ofrohet edhe **femijeve fillestare ne shkolle.**

Shpenzimet rreth perkujdesjes se nje femiu si dhe materiali mesimor dhe ai per loje perbejne shumen prej **10 € ne muaj dhe paguhet** (7 here ne vit)

Udheheqese e projektit:
Elisabeth Piwerka
Doblergasse 6, 8020 Graz
Tel.: 0699 140 326 63
e-mail: elisabeth.piwerka@alphanova.at
www.alphanova.at

HIPPY wird gefördert von:

Bundeskanzleramt

Bundesministerium
Arbeit, Familie und Jugend

KAPFENBERG
SPORT INDUSTRIE LEBEN